



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**NJOFTIM**  
**PER FILLIMIN E APLIKIMEVE PËR BURSË PËR**  
**STUDENTËT E CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE**  
**STUDENTË TË PROGRAMEVE PROFESIONALE PËR**  
**VITIN AKADEMIK 2024-2025**

**LISTA E DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PARAQESIN APLIKANTËT PËR BURSË SIPAS KATEGORIVE PËRFITUESE NË ZBATIM TË VKM nr.903 date 21.12.2019 te ndryshuar me VKM nr.39,DATË 23.01.2019.**

**A. Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike**

1. Kërkesë për tu trajtuar me bursë nga studentit aplikues;
2. Vërtetim që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike, ku të specifikohet numri i dosjes masa e ndihmës ekonomike (data e fillimit dhe e perfundimit te ndihmes ekonomike). Ky dokument te jete i protokolluar me firme dhe vule te njome.
3. Fotokopje e kartës së identitetit e studentit aplikues;
4. Çertifikatë familjare (portali e-albania);

**B. Bashkëshortët që kanë fëmijë, dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë**

1. Kërkesë për tu trajtuar me bursë nga studentit aplikues;
2. Fotokopje e kartës së identitetit e studentit aplikues;
3. Vërtetim nga Universiteti për secilin nga bashkëshortët student.
4. Çertifikatë familjare(portali e-albania);

**C.Studentët, persona me aftësi të kufizuara, te vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit te Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.**

1. Kërkesë me shkrim për t'u trajtuar me bursë nga studentit aplikues;
- 2.Çertifikatë Familjare (portali e-albania);
3. Fotokopje e kartës së identitetit;
4. Vërtetimi i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), (vërtetim origjinal ose kopje e noterizuar) për studentin me aftësi të kufizuar;
5. Vërtetim nga ISSH ose nga njesia e qeverisjes vendore për pagesën e aftësisë së kufizuar.

**Ç. Studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, te vërtetuara me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar).**

1. Kërkesë për t'u trajtuar me bursë nga studenti aplikues;
2. Vërtetim nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCA), (për të dy prindërit);
3. Vërtetim nga ISSH ose njesia e qeverisjes vendore për përfitimin e pensionit të invaliditetit ose të pagesës si person me aftësi të kufizuara, (për të dy prindërit)
4. Çertifikatë familjare portali e albania;
5. Fotokopje e kartës së identitetit të studentit aplikues.

**D. Studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë**

1. Kërkesë për t'u trajtuar me bursë nga studenti aplikues;
2. Çertifikatë familjare portali e albania;
3. Fotokopje e kartës së identitetit të studentit aplikues;
4. Vërtetim nga ISSH për të dy prindërit që janë pensionistë duke specifikuar edhe masën e pensionit.

**D/a. Studentët që kanë njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton.**

1. Kërkesë për t'u trajtuar me bursë nga studenti aplikues;
2. Çertifikatë familjare portali e albania;
3. Vërtetim nga ISSH për përfitimin e pensionit për njërin prind;
4. Fotokopje e kartës së identitetit të studentit aplikues;
5. Çertifikatë vdekjeje e prindit që nuk jeton.
6. Vërtetim nga ISSH që prindi tjetër është në pension duke specifikuar edhe masën e pensionit;
7. Vërtetim nga zyra e punës që prindi jetues është regjistruar si punëkërkuar i papunë

**DH. Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë.**

1. Kërkesë për t'u trajtuar me bursë nga studenti aplikues;
2. Çertifikatë familjare, portali e albania;
3. Fotokopje e kartës së identitetit të studentit aplikues;
4. Vërtetim se dy fëmijët e parë të familjes janë studentë nga Fakulteti përkatës ku janë student dhe vazhdojnë studimet.

**E. Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç**

1. Kërkesë për tu trajtuar me bursë nga studenti aplikues
2. Çertifikatë familjare portal e albania;
3. Fotokopje e kartës së identitetit;
4. Çertifikatën e vdekjes së dy prindërve;
5. Fotokopje e noterizuar e statusit të jetimit të përfituar nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe rinisë, Shërbimi Social Shtetëror.

**Ë. Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç**

1. Kërkesë me shkrim për tu trajtuar me bursë nga studenti aplikues
2. Çertifikatë familjare portal e albania;
3. Fotokopje e kartës së identitetit;
4. Vendim gjykatë i formës së prerë që studenti ka humbur përgjegjësinë prindërore ( nga të dy prindërit)

**F. Studentët që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;**

1. Kërkesë me shkrim për tu trajtuar me bursë nga studenti aplikues
2. Çertifikatë familjare portal e albania;
3. Fotokopje e kartës së identitetit;
4. Vërtetim i lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror për përfitimin e statusit ligjor për trajtimin si viktime të trafikut të qenieve njerëzore.

**G. Studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.”**

1. Kërkesë me shkrim për t’u trajtuar me bursë nga studenti aplikues
2. Çertifikatë familjare portal e albania;
3. Fotokopje e kartës së identitetit;
4. Çertifikatë vdekjeje e prindit që ka humbur jetën;
5. Vërtetim nga Ministria e Brendshme përkatëse për prindin e studentit që ka humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;

**GJ. Studentët e regjistruar në vitet pas të parit, me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) të vitit paraardhës akademik, të përlogaritur me kreditet, dhe notat e atij vitit akademik, nga Insitucionet Publike të Arsimit të Lartë.**

**H. Studentët e pranuar në vitin e parë akademik në UAMD me notë mesatare vjetore nga 9(nëntë ) deri në 10(dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë sipas listës së studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare të hartuar dhe të dërguar nga QSHA.**

Lista e studentëve të shkëlqyer dërgohet nga Fakulteti për miratim në Bordin Administrimit.

Dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, pa korrigjime, origjinal ose fotokopje të noterizuara dhe brenda 3 muajve të fundit.

**Studentët nuk përfitojnë bursë apo humbasin të drejtën e përfitimit në rast se:**

1. Vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi te cilët duhet të perballojnë koston e plotë të studimeve.
2. Nuk e kanë përfunduar programin e studimit brenda kohëzgjatjes normale të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkatës të studimit (studentët persëritës)

**DOKUMENTACIONI PËR STUDENTËT E FAKULTETIT TË BIZNESIT, FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKO JURIDIKE DHE STUDENTET E FAKULTETIT TE EDUKIMIT DORËZOHET PRANË ZYRËS SEKTORI JURIDIKA/138 GODINA E DYTË E KAMPUSIT UNIVERSITAR (UAMD) SPITALLË.**

**DOKUMENTACIONI PËR STUDENTËT E FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE FAKULTETIT TË STUDIMEVE PROFESIONALE DORËZOHET PRANË ZYRËS SEKTORI JURIDIK NR 214 NE CURRILA.**

***BURSA FINANCIARE PAGUHET NGA DATA E REGJISTRIMIT NE RASTET E APLIKIMIT NE FILLIM TE VITIT AKADEMIK OSE NGA MUAJI PASARDHES KU STUDENTI KA PARAQITUR KERKESEN NE RASTIN E PLOTESIMIT TE KRITEREVE  
TE PERCAKTUARA NE KETE NJOFTIM GJATE VITIT AKADEMIK***